



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
FEDERAL REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Dk:

Nr. i fq./ Bruar./ No. qg.

Data / Datum / Date

OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC

01-060-01-39212-24  
1-2  
26.12.2024



Republika e Kosovës

Republika Kosovo- Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Komuna Obiliq - Opštine Obilić - Municipality Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) nenit 14, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), bazuar në nenit 13 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.06/L-092 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10 e dt. 3 prill 2019, bazuar në nenin 6 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës bazuar në nenin 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës nr.-I-34, të dt.25.04.2016, nenin 39 të Rregullores së punës së Kuvendit si dhe Propozim Vendimin nr.- 02-020-01-38177-24, të dt.12.12.2024, Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajtur me dt. 24.12.2024, mori këtë:

## VENDIM

### **PËR MIRATIM PARAPRAK TË LISTËS SË PËRGJITHSHME DHE LISTËS SË VEÇANTË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS QË PLANIFIKOHEN PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË PËR VITIN VIJUES 2025**

#### Neni 1

- Sipas këtij vendimi Komuna e Obiliqit publikon Listën e Veçantë të pronave komunale për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për vitin vijues-2025 dhe Listën e përgjithëshme të pronave të paluajtshme të komunës, të përgaditura dhe të verifikuara nga ana e Komisionit komunal për verifikimin e pronave komunale si dhe publikimin e pronave komunale në web – faqen zyrtare të komunës.

#### Neni 2

Për pronat komunale të cilat do të jepen në shfrytëzim afatgjatë, gjatë vitit vijues komisioni ka përgaditur listen e veçantë e cila është pjesë e këtij propozim vendimi dhe Listën e përgjithëshme të pronave të paluajtshme të komunës.

#### Neni 3

Periudha kohore për pronat e paluajtshme Komunale që do të jepen në shfrytëzim afatgjatë 15-99.

#### Neni 4

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave komunale është rritja e vlerës së pronës së paluajtshme të komunës , zhvillimi i aktiviteteve biznesore si dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore .

#### Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtorati për Planifikim Urban, Pronë dhe Kadastër dhe Komisioni për verifikimin e pronave komunale.

#### Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të MAPL- dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

### ARSYETIM

Baza ligjore për miratimin e këtij Vendimi është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 13 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092, nenit 6 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe të nenit 72 pika 1.1.8 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.I-34 të datës 25.04.2016.

Kryetari i Komunës duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019 nenit 6 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës sipas autorizimeve të veta dhe me qëllim të realizimit të interesit publik rritjes së vlerës ekonomike të pronës së paluajtshme të komunës, krijimit të të hyrave vetanake në një anë dhe ofrimit të kushteve për krijimin e vendeve të reja të punës .

Këtij vendimi i bashkangjitet:

- Listën e veçantë të pronave të paluajtshme të komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për vitin vijues- 2025.
- Listën e përgjithëshme të pronave të paluajtshme të Komunës

- T'i dërgohet
- Kryetarit
- Nënkryetarit
- Kryesueses
- Anëtarëve të KK
- DPUKP
- MAPL
- Arkiv

  
Kryesuese e Kuvendit Komunal  
Vlora Mjekiqi Kabashi